



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 573 Akti

Nr. 568 Vendimi
Tiranë, më 29.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 27.9.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ervisa Hyka**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; **Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ervisa Hyka, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.6.2020 u caktua me mirëkuptim si kryesuese, znj. Brunilda Bekteshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në

¹ Akti i përfundimit të kontrollit me nr. *** prot., datë 10.4.2018.

përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, duke dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 13.9.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.9.2022, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 14.9.2022, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datat 21 dhe 22.9.2022 (nëpërmjet postës elektronike dhe depozitimit në protokollin e Komisionit).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 23.9.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Ervisa Hyka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.9.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

² Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 17.6.2022, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 17.12.2021.

18. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Ervisa Hyka ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4. Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në

⁴“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato dhëna gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

21.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

21.2. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 20.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

22. Pasuria e llojit “likuiditet”, gjendje *cash*, në shumën 840,000 lekë.

22.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar, të ardhurat e kursyera nga paga për periudhën e punësimit, nëntor 2011 deri në momentin e deklarimit.

22.2. Deklarimi i likuiditeteve *cash* në vite:

- i. Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (këtej e në vijim DIP) të vitit 2014, në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar të ardhura të tjera të kursyera nga paga, shumën **290,000 lekë**.
- ii. Në DIP/2015, në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar kursime *cash* nga paga, shumën **350,000 lekë**.
- iii. Në DIP/2016, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar para *cash* të kursyera nga paga vjetore pranë Prokurorisë Fier, për periudhën 1 janar 2016 – 31 dhjetor 2016, shumën **300,000 lekë**.

22.3. Konkluzionet e ILDKPKI-së për këtë pasuri: subjekti ka realizuar të ardhura, të cilat justifikojnë gjendjen e deklaruar.

Analiza e kryer nga Komisioni për këtë pasuri

24. Komisioni konstaton se në DIP/2014 dhe DIP/2015, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë kursimet e saj në formë likuiditetesh *cash* në rubrikën e të ardhurave, pasi ato do të duhej të deklaroheshin në rubrikën e ndryshimit të pasurive, ku pasqyrohen shtesat dhe pakësimet e pasurisë.

24.1. Gjithsesi, Komisioni vëren se, në deklarimin e bërë për këto dy vite, subjekti ka qenë e qartë në përshkrimin e dhënë, duke specifikuar se kemi të bëjmë me kursime, kjo nisur edhe nga fakti se në këto deklarata, në seksionin e të ardhurave, subjekti fillimisht ka deklaruar

shumën totale të të ardhurave të përfituara gjatë vitit dhe në vijim ka shënuar vlerën e të ardhurave të kursyera në formë likuiditetesh *cash*, krahas atyre gjendje në llogari bankare⁵.

24.2. Pra, referuar vetëdeklarimeve të bëra, rezulton se në fund të vitit 2016 (datë 31.12.2016) subjekti i rivlerësimit ka disponuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 940,000 lekë. Ndërsa, siç u konstatua më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” (dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.1.2017) ka deklaruar se disponon gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 840,000 lekë.

24.3. Bazuar në analizën e treguesve financiarë, të kryer nga Komisioni⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat kanë mundësuar plotësisht krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 840,000 lekë.

25. Pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë “****” në “Credins Bank”, krijuar me të ardhurat nga paga prej vitit 2012, në shumën 10,805 lekë.

25.1. Referuar deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, konstatohet se:

- i. Në DIP/2012, në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në shumën 40,000 lekë;
- ii. Në DIP/2014, në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar depozitë bankare “****”, krijuar me të ardhurat nga paga, në shumën 153,979 lekë;
- iii. Në DIP/2015, në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, subjekti ka deklaruar depozitë bankare “****” krijuar me të ardhurat nga paga, me gjendje në datën 31.12.2015, në shumën 39,674 lekë; dhe
- iv. Në DIP/2016, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar të ardhura të kursyera nga paga vjetore si prokurore, në depozitën “****” pranë Bankës “Credins”, për periudhën 1 janar 2016 – 31 dhjetor 2016, shumën 10,805 lekë.

25.2. “Credins Bank”⁷, konfirmon se në vitin 2012 subjekti i rivlerësimit ka hapur llogarinë me nr. *** dhe se nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, balancat e gjendjeve në fund të çdo viti (për vitet 2012 – 2016) paraqiten si vijon: (i) në datën 31.12.2012, në shumën 41,138 lekë; (ii) në datën 31.12.2013, në shumën 72,255 lekë; (iii) në datën 31.12.2014, në shumën 153,979 lekë; (iv) në datën 31.12.2015, në shumën 39,674 lekë; dhe (v) në datën 31.12.2016, në shumën 10,805 lekë.

25.3. Komisioni konstaton se në DIP/2013 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen e kësaj llogarie. Gjithashtu, konstatohet se në DIP/2012, DIP/2014 dhe DIP/ 2015, subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë gjendjet e kësaj llogarie në rubrikën e të ardhurave, pasi ato do të duhej të deklaroheshin në rubrikën e ndryshimit të pasurive, ku pasqyrohen shtesat dhe pakësimet e pasurisë.

25.4. Gjithsesi, nga verifikimi i kësaj llogarie rezulton se ajo kreditohet nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” dhe gjithashtu konfirmohet se gjendja e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka qenë në vlerën 10,805 lekë.

25.5. Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e llogarisë në “Credins Bank” dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj.

⁵ Referoju deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë, të viteve 2014 dhe 2015, të dorëzuara në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit Ervisa Hyka.

⁶ Referoju tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneksi nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 29.12.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.12.2020.

26. Pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë “**” në “Credins Bank”, krijuar me të ardhurat nga paga prej vitit 2015, në shumën 20,000 lekë.**

26.1. Në mbështetje të deklaramit të bërë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentin *certifikatë e pronësisë së kuotave*⁸ në shoqërinë “****”, nga ku rezulton se deri në datën 31.12.2016, ajo zotëron 20,494 lekë, shuma ekuivalente në kuota të investuara në këtë fond pensioni.

26.2. Nga verifikimi i deklaramëve periodike vjetore, të bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, rezulton se në DIP/2016, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga vjetore si prokurore, në llogarinë “****” pranë “Credins Bank”, për periudhën 1 janar 2016 – 31 dhjetor 2016, në shumën 16,000 lekë.

26.3. Referuar lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank”⁹ (llogaria nr. ****) rezulton se nga muaji shtator 2015 debitohet nga kjo llogari shuma prej 2,000 lekësh në muaj në fondin “****” me përshkrimin “kontribut fondi ****”.

26.4. Rezulton se përgjatë vitit 2015 është debituar nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank” drejt fondit “****”, në total shuma prej 4,000 lekësh, ndërsa, gjatë vitit 2016 është debituar në total shuma prej 16,000 lekësh. Vërehet se në DIP/2015 subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e fondit të pensionit në “****”, në shumën 4,000 lekë.

26.5. Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e fondit të pensionit në “****” dhe se nuk ka dyshime për krijimin e kësaj shume.

ÇËSHTJE TË TJERA

27. Adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vite

27.1. Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë ku është i regjistruar në Gjendjen Civile: *“Fier, lagja ***, rruga ****”, Njësia nr. ***, pallati ****”*.

27.2. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë periodikë/vjetorë të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se:

- i. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (dorëzuar në datën 14.12.2011) dhe në DIP 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) si adresë ku është e regjistruar në Gjendjen Civile: *“Lagja ***, rruga ****”, pallati nr. ***, shkalla nr. ***, apartamenti nr. ***, Fier”*; dhe (ii) si vendqëndrim tjetër, adresë ku banon: *“****”, mbrapa ambasadës amerikane, Tiranë”*.
- ii. Në DIP/2012 ka deklaruar: (i) si adresë ku është e regjistruar në Gjendjen Civile: *“Rruga ****”, Lagja ***, pallati nr. ***, kati ***, shkalla nr. ***, apartamenti nr. ****”*; dhe (ii) si vendqëndrim tjetër, adresë ku banon: *“****, ndërtesë 3-katëshe pranë spitalit F, QSUT, Tiranë”*.
- iii. Në DIP/2013 ka deklaruar: (i) si adresë ku është e regjistruar në Gjendjen Civile: *“Lagja ***, rruga ****”, pallati nr. ***, Fier”*; dhe (ii) si vendqëndrim tjetër, adresë ku banon: *“Lagjia ***, rruga ****”, pallati nr. ***, Fier”*.
- iv. Në DIP/2014 dhe DIP/2015 ka deklaruar: (i) si adresë ku është e regjistruar në Gjendjen Civile: *“Lagja ***, rruga ****”, pallati nr. ***, kati ***, Sh. ***, Ap. ***, Fier”*; dhe (ii) si vendqëndrim tjetër – adresë ku banon: *“Lagjia ***, rruga ****”, pallati i ***, kati ***, Fier”*.
- v. Në DIP/2016, ka deklaruar si adresë ku është e regjistruar në Gjendjen Civile: *“Fier, Lagja ***, rruga ****”, Pallati ***, Ap. ****”*.

⁸ Dokument i ndodhur në ankesin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Referoju informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë me shkresën e “Credins Bank” me nr. *** prot., datë 29.12.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.12.2020.

27.3. Gjithashtu, Komisioni konstaton se në deklaratën për kontrollin e figurës (Shtojca 3) subjekti ka deklaruar historikun e adresave të saj të banimit, duke filluar nga data 1.1.2012, si vijon: (i) për periudhën 01/2012 – 09/2012 ka deklaruar adresën: “Tiranë, Njësia ***, rruga ***, pranë Ambasadës Amerikane, banesë private”; (ii) për periudhën 09/2012 – 02/2013 ka deklaruar adresën: “Tiranë, Njësia ***, pallat pranë Qendrës K”, (iii) për periudhën 02/2013 – 09/2013 ka deklaruar adresën: “Tiranë, Njësia ***, rruga ***, pranë QSUT – Nënë Tereza, banesë private”; dhe (iv) për periudhën 06/2013 – e deri në momentin e dorëzimit të deklaratës (datë 24.1.2017) ka deklaruar si adresë: “Fier, Njësia ***, Lagja ***, rruga “****”, pallati ****”.

27.4. E pyetur në lidhje me adresat e banimit (pyetëtori nr. 1, i dërguar nga Komisioni) që nga momenti i fillimit të detyrës e në vijim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se:

i) “Për periudhën nga muaji nëntor i vitit 2011 dhe deri në qershor 2013, kur është larguar me detyrë në Prokurorinë e Vlorës, deklaroi se ka jetuar në këto adresa:

(a) Një garsoniere në një ndërtesë katërkatëshe në rrugën “****”, prapa Ambasadës Amerikane. Në këtë objekt, ka jetuar së bashku me shoqet e saj të fakultetit L.L dhe B.H nga viti 2007, kur kanë qenë në vitin e katërt të fakultetit. Pas mbarimit të fakultetit është shkëputur një vit dhe është kthyer në Fier, ku ka studiuar për provimin e shkollës së Magjistraturës dhe pas fitimit të konkursit është kthyer përsëri në Tiranë. Qiraja e garsonieres ka qenë 20,000 lekë, e cila pjestohej midis tyre në vlerën 7,000 lekë. Emrin e pronarit të objektit nuk e mban mend, pasi nuk ka pasur komunikime me këtë person dhe pagesën totale të qirasë e dorëzonte L. L, me të cilën nuk mban kontakte nga muaji shkurt i vitit 2013;

(b) Një apartament me qira në vlerën 25,000 lekë në lagjen “****”, në një pallat që ndodhet përbri me kompleksin “****”, ku ka jetuar së bashku me shoqen e fakultetit L.L nga muaji shtator 2012 deri në muajin shkurt 2013. Nuk ka dijeni në lidhje me identitetin e pronarit pasi kontaktet për pagesën e qirasë i mbante L.L, me të cilën ka ndërprerë kontaktet dhe nuk ka komunikim që nga ajo kohë. Vlera e qirasë që paguhej prej saj ishte 12,500 lekë;

(c) Një garsoniere në vlerën 16,000 lekë në një ndërtesë trekatëshe që ndodhej në zonën e QSUT-së, pranë spitalit nr. ***, Tiranë, ku ka qëndruar së bashku me shoqen e saj E.Ç, nga muaji mars 2013 deri në muajin qershor 2013. Nuk ka dijeni në lidhje me identitetin e pronares, pasi kontaktet me të i mbante E, e cila i dorëzonte dhe pagesën e qirasë. Vlera e qirasë që paguhej prej saj ishte 8,000 lekë.

ii. Nga muaji qershor i vitit 2013 e në vijim jeton në banesën e prindërve të saj... Bëhet fjalë për një apartament me sipërfaqe 42.16 m2, me nr. pasurie ***, z.k.***, vol.***, fq***, i ndodhur në lagjen “****”, Fier. Ky apartament është fituar mbi bazën e Kontratës së Shkëmbimit për Pasuri të Paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.8.2016, lidhur para noterit G.M, midis palës së parë këmbyses Bashkia Fier dhe palës së dytë këmbyses, K. H, N.H, H.H, N. H, Z.H, N.H, E.H, T.H, Xh.H, S.H, S. H, D. L dhe G.Xh... ”.

27.5. Nga verifikimi dhe analizimi në harmoni i deklarimeve të bëra lidhur me adresat e banimit, Komisioni konstaton se në formularët e ILDKPKI-së, krahas adresës ku ka qenë e regjistruar në Gjendjen Civile, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe vendqendrimet, adresat e tjera të banimit në momentin e dorëzimit të deklaratës.

27.6. Gjithashtu, rezulton se në vazhdimësi subjekti i rivlerësimit ka qenë e regjistruar si banore e qytetit të Fierit, duke qenë fillimisht e regjistruar me gjendje civile në adresën e cila përkon me pasurinë e privatizuar nga prindërit e saj në vitin 1993. Ndërsa, prej vitit 2016, figuron e regjistruar me gjendje civile në adresën e cila përkon me pasurinë, apartamentin, aktualisht në bashkëpronësi të prindërve të saj, fituar prej tyre nëpërmjet shkëmbimit me banesën e përfiturar më parë nga privatizimi dhe dhurimit të pjesëve takuese nga bashkëpronarët e tjerë, për të cilën rezulton se shkëmbimi faktik është bërë gjatë viteve '90, porse praktika për kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat hipotekorë është kryer në vitin 2016.

28. Automjeti i deklaruar në përdorim

28.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni, e pyetur nëse gjatë periudhës së deklarimit ka përdorur ndonjëherë pronë të regjistruara në emër të dikujt tjetër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se “...Gjatë periudhës së deklarimit, gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e saj si prokurore në Prokurorinë e Vlorës, për periudhën nga muaji dhjetor i vitit 2013 deri në muajin qershor 2015, kur ka ardhur me detyrë në Prokurorinë Fier, ka përdorur mjetin “***” me targa AA ***, vit prodhimi 2000, në pronësi të kunatit të saj N.K, bashkëshorti i motrës J. K. Mjeti në fjalë është blerë dhe regjistruar nga kunati i saj në muajin tetor 2011, përpara emërimit të saj në detyrë si prokurore (datë 16 nëntor 2011)...Aktualisht, për shkak se jeton dhe punon në të njëjtin qytet prej pesë vitesh, në Fier, këtë mjet e ka përdorur rrallë për arsye familjare.” Në mbështetje të deklarimit të bërë, subjekti ka depozituar kopje të dokumenteve: (i) certifikata e pronësisë së mjetit rrugor; (ii) deklaratë doganore dhe urdhërçlirimi të automjetit nga autoriteti doganor. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se në datën 26.10.2011 ky automjet është regjistruar në emër të shtetasit N. K.

28.2. Nga verifikimi i informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit¹⁰ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka 1 (një) hyrje/dalje jashtë territorit shqiptar me këtë automjet, por se në këtë udhëtim ka qenë edhe kunati i saj, pronari i automjetit, dhe se ky i fundit është regjistruar në sistemin TIMS, si shofer. Gjithashtu, referuar informacionit të dërguar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare¹¹ dhe verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin e këtij autoriteti, nuk rezulton që për këtë automjet të jetë shënuar “si përdorues” emri i subjektit të rivlerësimit, në polica sigurimi të llojit TPL/policë kufitare/karton jeshil.

28.3. DPSHTRR-ja¹² konfirmon se automjeti me targë AA121BG është i regjistruar në emër të shtetasit N.K. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti, Komisioni konstaton se: (i) ky automjet figuron të ketë qenë i regjistruar në Hollandë në emër të shtetasit N.K deri në datën 4.10.2011 kur është çregjistruar për eksport; (ii) në datën 6.10.2011, shtetasi N.K ka paguar detyrimet doganore në shumën 74,340 lekë; vlera statistikore (referenca) e shënuar për këtë automjet në shumën 371,000 lekë; (iii) në datën 12.10.2011 është kryer kontrolli fizik i këtij automjeti dhe është lëshuar certifikata përkatëse nga DRSHTRR-ja Fier; dhe (iv) në datën 26.10.2011 ky automjet është regjistruar në emër të shtetasit N.K.

28.4. Sa më sipër, rezulton se ky automjet është blerë nga bashkëshorti i motrës së subjektit përpara se ajo të emërohej përkohësisht në detyrën e prokurorit për periudhën e stazhit dhe se Komisioni nuk ka dyshime se ajo mund të ketë pasur kontribut në krijimin e kësaj pasurie.

¹⁰ Shkresa e DPPSH-së me nr. *** prot., datë 11.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.9.2020.

¹¹ Shkresa e AMF-së me nr. *** prot., datë 22.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.9.2020.

¹² Shkresa e DPSHTRR-së me nr. *** prot., datë 14.7.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.7.2022.

Hetimi i kryer për prindërit e subjektit të rivlerësimit

29. Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe shterues, Komisioni kreu verifikime mbi pasuritë e prindërve të subjektit të rivlerësimit¹³. Nga hetimi i kryer rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë krijuar apo shtuar pasuri të paluajtshme dhe/apo pasuri të luajtshme (automjete, likuiditete, etj.) gjatë periudhës në të cilën ajo ka ushtruar funksionin e prokurorit. Gjithashtu, nuk u konstatuan transaksione të dyshimta të kryera prej tyre.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

30. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

30.1. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ajo ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj.

30.2. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike/vjetore, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

30.3. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

30.4. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

31. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ajo ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona

¹³Shkresa e Komisionit drejtuar bankave dhe institucioneve financiare me nr. *** prot., datë 5.7.2022 dhe kthim përgjigjet e bankave dhe institucioneve financiare, të administruara në dosjen e hetimit administrativ; shkresa e Komisionit drejtuar DPSHTRR-së me nr. *** prot., datë 5.7.2022 dhe kthim përgjigjet me nr. *** prot., datë 14.7.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.7.2022); shkresa e Komisionit drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Regjistrimit Noterial, me nr. *** prot., datë 5.7.2022 dhe kthim përgjigjja me nr. *** prot., datë 18.8.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.8.2022); shkresa e Komisionit drejtuar OSHEE – FSHU-së, me nr. *** prot., datë 5.7.2022 dhe kthim përgjigjja me nr. *** prot., datë 21.7.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.7.2022); shkresa e Komisionit drejtuar OSHEE – FSHU, me nr. *** prot., datë 29.7.2022 dhe kthim përgjigjja me nr. *** prot., datë 9.9.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.9.2022); shkresa e Komisionit drejtuar DPPPP-së me nr. *** prot., datë 5.7.2022 dhe kthim përgjigjja e administruar në dosjen e materialeve të karakterit “konfidencial/sekret”; aplikimet e bëra nga Komisioni në sistemin elektronik multifunksional të ASHK-së me nr. kërkesë *** dhe *** , datë 30.8.2022, si edhe 2 (dy) vërtetimet e lëshuara nga ASHK-ja (me vulë elektronike), në përgjigje të aplikimeve të bëra; Verifikimet e kryera nga Komisioni në sistemin elektronik multifunksional të ASHK-së (aksesuar me kredencialet – përdoruesin dhe fjalëkalimin përkatës) dhe dokumentacioni i printuar nga ky sistem lidhur me pasurinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit – apartamentit në Fier; verifikime të kryera nga Komisioni në faqen zyrtare të QKB-së dhe në faqen zyrtare të AMF-së.

të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

31.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

31.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

31.3. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

32. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ervisa Hyka ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

33. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale, i cili është është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklaramentit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklaramentit; (2) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

33.1. Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin të ligjit, si edhe shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Në vijim konstatohet se ajo ka përballuar me efikasitet ngarkesën e punës dhe se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

34. Subjekti i rivlerësimit, në datën 16.11.2011, është caktuar në detyrën e prokurorit për periudhën e stazhit, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. ***, datë 12.10.2012, të Presidentit të Republikës, është emëruar si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pavarësisht këtij emërimi, ajo ka qenë e komanduar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një periudhë 8 - mujore, deri në muajin qershor të vitit 2013. Nga muaji korrik 2013 deri në 16 tetor të vitit 2015 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në vijim, nga muaji tetor i vitit 2015 e aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier.

34.1. Hetimi i Komisionit për këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni në këtë kuadër; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

34.2. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

34.3. Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, pas shqyrtimit të dosjes nr. 5 të shortuar, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegimet/argumentet e saj mbi interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm të cilat e çuan fillimisht në konkluzionin për pushimin e çështjes dhe në vijim për dërgimin e saj në gjyq.

34.4. Pas administrimit të prapësimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse sa i përket vendimmarrjes së saj mbi çështjen objekt verifikimi/vlerësimi.

34.5. Në vlerësimin e prokurores Hyka u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 8 (tetë) denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe analizimit të tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japi shpjegime dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej saj në hetimin dhe/apo shqyrtimin e çështjeve që lidhen me 3 (tri) denoncime të depozituara nga publiku, përkatësisht denoncimin/ankesën e bërë nga shoqëria përmbarimore “****”¹⁴ sh.p.k., denoncimin e bërë nga avokati A.B¹⁵ dhe denoncimin e bërë nga shtetasi S.A¹⁶.

34.6. Komisioni, pasi administroi prapësimet e subjektit, të shoqëruara nga shpjegimet dhe provat përkatëse, si dhe pasi i vlerësoi ato me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e konstatuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e publikut. Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që, mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

35. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

35.1. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

¹⁴ Ankesa nr. *** prot., datë 5.7.2019.

¹⁵ Ankesa nr. *** prot., datë 19.6.2021.

¹⁶ Ankesa nr. *** prot., datë 20.7.2022.

IV. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

36. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ervisa Hyka, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 29.9.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Pamela QIRKO

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Amela Idrizi

Sekretare gjyqësore

ANEKS - 1

**TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE
PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ERVISA HYKA**

Analiza e treguesve financiarë sipas periudhave përkatëse.	1.11.2011 - 31.12.2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	15	50 783	21 621	371 587	236 472	270 656
Ndryshim likuiditeti	15	50 783	21 621	371 587	236 472	270 656
B) Detyrime	0	0	0	0	0	0
C) Pasuri neto (A-B)	15	50 783	21 621	371 587	236 472	270 656
D) Të ardhura	39 615	872 160	856 209	1 216 389	1 318 129	1 083 452
Të ardhura nga paga e subjektit	39 615	872 160	856 209	1 216 389	1 318 129	1 083 452
E) Shpenzime	36 770	241 524	222 524	476 811	358 041	241 856
Shpenzime minimale jetike	22 770	141 024	141 024	219 998	224 276	235 092
Shpenzime udhëtime Fier - Vlorë - Fier.			20 000	240 000	120 000	
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit				16 813	13 765	6 764
Shpenzime qiraje	14 000	100 500	61 500			
Balanca e fondeve (D-C-E)	2 830	579 853	612 064	367 991	723 616	570 941

